

L I G J
Nr.8058, datë 8.2.1996

**PËR FALJEN E DETYRIMEVE TË VITEVE 1994 DHE 1995 TË KORPARATËS
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE NDAJ BUXHETIT TË SHTETIT**

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Falen detyrimet që ka Korparata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH-it) ndaj buxhetit të shtetit për akcizën, të pashlyera deri në datën 31.12.1995 dhe që i përkasin viteve 1994-1995.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1368, datë 16.2.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha